



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr ____prot

Tiranë më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 273, datë 29.05.2024

PËR

PËRFUNDIMIN PA VENDIM PËRFUNDIMTAR
TË PROCEDURËS SË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL
TË GJYQTARES SË KOMANDUAR NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR ZNJ. {...},
PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 01.01.2019-15.04.2021

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 29.05.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja znj. Yllka Rupa, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, të gjyqtares të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-15.04.2021”

VËREN:

I. FAKTET E ÇËSHTJES DHE PROCEDURA E ZHVILLUAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 226, datë 02.06.2021, ka vendosur verifikimin e plotësimit të tre kriterëve të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës (*aktualisht Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm*) për gjyqtaren {...}, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021.

Pas plotësimit të Skemës së Vlerësimit të Gjyqtarëve me rregullat për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, miratuar me vendimin e KLGJ nr.159, datë 05.04.2023,¹ Këshilli me vendimin nr.175, datë 25.04.2023 ka vendosur:

¹ Hyrë në fuqi në datën 13.04.2023, pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 63., datë 13.04.2023.

- “1. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-15.04.2021, për gjyqtaren e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, znj. {...}, gjatë ushtrimit të detyrës së nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqësorëve (Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Këshillin e Lartë Gjyqësor).*
- 2. Caktimin e znj. Yllka Rupa si relatore për vlerësimin e gjyqtarës së komanduar, znj. {...}”.*

Pas marrjes së këtij vendimi, ka vijuar procedura e vlerësimit sipas parashikimeve të nenit 86 e vijues të Ligjit të Statusit dhe vendimit nr.159, datë 05.04.2023, duke u kryer veprimet si më poshtë:

Në datën 25.04.2023, në bazë të neneve 89, pika 3 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në vendimin nr. 159, datë 05.04.2023, “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, gjyqtarja është njoftuar nëpërmjet postës elektronike për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-15.04.2021, për vlerësuesin e përzgjedhur në bazë të shortit dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tij, ose të cilitdo anëtar të Këshillit.

Brenda afatit 3 ditor, në datën 26.04.2023, gjyqtarja {...}, nëpërmjet postës elektronike ka konfirmuar marrjen e njoftimit, ka bashkëlidhur deklaratën për adresën elektronike dhe kontaktet telefonike, duke deklaruar se është dakord me vlerësuesin, si dhe nuk ka kërkesë për përjashtimin e tij, ose të ndonjë anëtar të Këshillit.

Gjithashtu, gjyqtarja në njoftimin e datës 25.04.2023 është njoftuar se në bazë të nenit 22, pika 5 të vendimit nr.159, datë 05.04.2023 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, brenda 1 (një) jave nga fillimi i procedurës së vlerësimit duhet të hartojë raportin e punës për të gjithë periudhën e vlerësimit dhe ta depozitoi atë në zyrë e protokollit të Këshillit.

Në datën 08.05.2023, me nr.2779 prot., gjyqtarja ka dorëzuar në zyrë e protokollit “*Raporti përshkrues i punës së gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor*”, sipas formës standarde të miratuar.

Në datën 28.04.2023, nëpërmjet shkresës me nr. 2642 prot., Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i është kërkuar informacion lidhur me të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarës {...}, gjatë periudhës së vlerësimit, 01.01.2019-15.04.2021. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1437/1 prot., datë 11.05.2023, protokolluar në KLGJ me nr.2642/3, datë 12.05.2023. Gjithashtu është administruar informacioni i dërguar Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr.2228/1 prot., datë 31.07.2023, protokolluar në KLGJ me nr.

2558/6 prot., datë 02.08.2023 mbi ecurinë e trajtimit të praktikës lidhur me kërkesën e Presidentit të Republikës së Shqipërisë mbi procedimin disiplinor të zhvilluar ndaj gjyqtares {...}.

Në datën 28.04.2023, nëpërmjet shkresës me nr. 2642/1 prot., Shkollës së Magjistraturës i është kërkuar informacion lidhur me pjesëmarrjen dhe përfshirjen e gjyqtares së komanduar {...} në veprimtaritë trajnuese gjatë periudhës së vlerësimit. Shkolla e Magjistraturës ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 301/15 prot., datë 05.05.2023, protokolluar në KLGJ me nr. 2642/2, datë 05.05.2023.

Pjesë e dosjes së vlerësimit është bërë edhe kopja e aktit përfundimtar të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë, të dërguar nga ILDKPKI me shkresën nr. 482/23 prot., datë 31.01.2022, protokolluar në KLGJ me nr. 666/1 prot., datë 01.02.2022.

Pas depozitimit nga ana e gjyqtares të raportit përshkruar të punës, nëpërmjet postës elektronike, në datën 09.05.2023, është njoftuar Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe subjekteve të tjera të rivlerësimit, në cilësinë e strukturës përgjegjëse organizative, për plotësimin e formatit standard të mendimit të strukturës përgjegjëse organizative. Formatit standard “Mendim i strukturës përgjegjëse organizative” është plotësuar dhe depozituar në zyrën e protokollit në Këshill në datën 22.05.2023, protokolluar me aktin nr. 2779/2 prot.

Gjithashtu, në po të njëjtin datë, nëpërmjet postës elektronike, është njoftuar Sekretari i Përgjithshëm në Këshill, në cilësinë e strukturës përgjegjëse administrative, për plotësimin e formatit standard të mendimit të strukturës përgjegjëse administrative, i cili përmban mendimin dhe vlerësimin që kjo strukturë i bën gjyqtares së komanduar, për shkak të mbikëqyrjes në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë administrative të punës së gjyqtares së komanduar. Formatit standard “Mendim i strukturës përgjegjëse administrative” është plotësuar dhe depozituar në zyrën e protokollit në Këshill në datën 17.05.2023, protokolluar me aktin nr. 2779/1 prot.

Në datën 24.05.2023, gjyqtares {...} i është dërguar nëpërmjet postës elektronike njoftimi për plotësimin e “Formatit standard të vetëvlerësimit të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, duke i bërë me dije të drejtën për të plotësuar në një rubrikë të veçantë komentet ose kundërshtimet në lidhje me mendimet e strukturës përgjegjëse organizative dhe administrative. Në datën 02.06.2023, me nr.2779/3 prot., gjyqtarja ka depozituar në zyrën e protokollit në Këshill “Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Kandidatja znj. {...}, me kërkesën e datës 23.01.2024 protokolluar në Këshill me aktin nr. 477 Prot., datë 24.01.2024 parashtrori kërkesën për heqje dorë nga kandidimi.

Ndërkohë që procedura e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor nuk ka përfunduar, Këshilli me vendimin nr. 37, datë 31.01.2024, pas shqyrtimit të kërkesës së kandidates për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë, ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit Përgjithshëm, për pozicionin e lire në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.129, datë 01.04.2021, për znj. {...}.

II. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

Në ligjin nr.96/2016 nuk ka një parashikim të shprehur për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional pa vendim përfundimtar, ndërkohë që në nenin 9 të vendimit të KLGJ-së nr.159, datë 05.04.2023, parashikohet vetëm përfundimi pa vendim përfundimtar i procedurës së vlerësimit në rastet e mbarimit të statusit të gjyqtarit. Pavarësisht se në aktet e sipërcituara nuk ka një përcaktim të shprehur që rregullon situatën faktike në fjalë, në zbatim të nenit 97, pika 3 të ligjit 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, Këshilli zbaton K.Pr.Administrative, në nenin 95 të së cilit parashikohet se: “*Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur*”.

III. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

Pas përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë për shkak të tërheqjes së kandidates, procedura e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-15.04.2021 për gjyqtaren e komanduar në KLGJ, gjatë ushtrimit të detyrës së nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, nuk mund të vazhdojë. Kjo procedurë vlerësimi, e filluar në rastin konkret për shkak të kandidimit për ngritje në detyrë, zhvillohet bazuar në nenin 23, pika 2 të vendimit të KLGJ-së nr.159, datë 05.04.2023 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”. Këto rregulla parashikojnë detyrimin e Këshillit që “*Nëse gjyqtari që nuk e ka përfunduar komandimin në momentin e hyrjes në fuqi të këtyre rregullave, ka kandiduar në procedura të lëvizjeve paralele ose ngritjes në detyrë, të shpallura para hyrjes në fuqi të këtyre rregullave dhe veç gradimit (vlerësim i parë) nuk ka vlerësim tjetër të fundit në kohë, të kryer apo që mund të kryhet sipas programeve të vlerësimit të miratuara nga Këshilli, vlerësimi fillon sipas një programi të veçantë, jo më vonë se dy javë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Në këtë rast periudha e vlerësimit llogaritet nga data e fillimit të komandimit, por jo më parë se data 01.01.2019 dhe shtrihet deri në momentin e kandidimit. Periudha e vlerësimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit*”.

Zhvillimi i kësaj procedure, e cila inicohet pas kërkesës së gjyqtarit për lëvizje paralele ose ngritje në detyrë dhe kualifikimit të tij për plotësim të kriterëve ligjore, synon të garantojë zhvillimin e një procesi të shpejtë, efektiv dhe të njëjtë vlerësimi për periudhën përkatëse të vlerësimit, për të

siguruar të paktën 1 vlerësim profesional në kohë, të njëjtë dhe real me atë të kërkesës së gjyqtarit për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele.

Në kushtet kur procedura e ngritjes në detyrë, për shkak të së cilës ka filluar procedura e vlerësimit të gjyqtares {...} për periudhën 01.01.2019-15.04.2021 ka përfunduar, rezulton se, shkak për të cilin procedura e vlerësimit ka filluar nuk ekziston më dhe për pasojë, zhvillimi i kësaj procedure të posaçme vlerësimi, ka humbur qëllimin për të cilin ka filluar.

Në rastin konkret, me deklarinimin e përfundimit të procedurës për ngritjen në detyrë të gjyqtares, shkak për të cilin ka filluar me prioritet procedura e vlerësimit të gjyqtares të komanduar, ka rënë shkak për të cilin kjo e fundit ka filluar dhe për këtë arsye, vlerësohet se qëllimi i këtij procesi nuk ekziston më. Për pasojë vijimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 01.01.2019-15.04.2021 nuk mund të vazhdojë. Ndërkohë kjo periudhë për të cilin kishte filluar kjo procedurë vlerësimi për gjyqtaren znj. {...}, do të përfshihet në periudhën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares së komanduar, pas përfundimit të afatit të komandimit, sipas parashikimeve të nenit 13 të vendimit të KLGJ-së nr.159, datë 05.04.2023 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Për sa arsyetohet më lart, Këshilli vlerëson se procedura e vlerësimit për gjyqtaren {...}, e filluar me vendimin nr.175, datë 25.04.2023, duhet të përfundojë pa vendim përfundimtar, për shkak të rënies së shkakut të fillimit të saj.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 68 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 61 pika 1, 63 dhe 86 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 159, datë 05.04.2023 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, nr. 70 datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” dhe atë nr. 37, datë 31.01.2024, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale;

VENDOSI:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, të gjyqtares të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën 01.01.2019-15.04.2021 për shkak të përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit

të Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin nr. 37, datë 31.01.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Periudha e vlerësimit 01.01.2019-15.04.2021 do të përfshihet në periudhën e vlerësimit etik dhe profesional në të cilën ajo bën pjesë, sipas parashikimeve të nenit 13, të vendimit të KLGJ-së nr.159, datë 05.04.2023 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.
3. Një kopje e vendimit t’i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR